

Çështje me interes:

Konferenca e ESSE-s

Propozime për dy numrat e *in esse*

Propozime për konferencën e dytë të ASSE-s

Kartolina e urimit

Në emër të Bordit të ASSE-s dhe në emrin tim personalisht, dëshiroj t'ju uroj **'Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri!'** Qoftë ky, një vit i mbarë për të gjithë ju, me suksese në punën tuaj profesionale dhe shëndet e lumturi për familjet tuaja!

Ky vit e gjen ASSE-n më të konsoliduar, me një aktivitet shkencor në rritje dhe me një interesim më të madh kombëtar për t'u bërë pjesë e saj. I urojmë ASSE-s një vit edhe më të mbarë me projekte shkencore më ambicioze.



Gëzuar!
Armela Panajoti

Në këtë numër:

Kartolina e urimit	1
Konferenca e ESSE-s	1
Anëtarësime të reja	2
Kuotacionet për vitin 2012	
Propozime për dy numrat e <i>in esse</i>	3
Botimet e konferencës 'Only connect ...'	3
Konferenca e dytë e ASSE-s	

Konferenca e ESSE-s

Shoqata Evropiane për Studimet në Gjuhën Angleze organizon konferencën e saj të njëmbëdhjetë në Stamboll të Turqisë në datat 2-4 shtator 2012. Konferencat e ESSE-s janë ndër konferencat më elitare që zhvillohen në fushën e studimeve në gjuhën angleze. Përveç se karakterizohen nga një nivel i lartë shkencor, ato kanë edhe një pjesëmarrje të jashtëzakonshme.

Ne ju kemi informuar në *newsletter*-in e muajit gusht 2010 për konferencën e dhjetë të ESSE-s, e cila u zhvillua në fund të gushtit 2010 në Torino në Itali. Konferenca ishte një nga aktivitetet më madhështore që ESSE ka organizuar ndonjëherë.


Mënyra e organizimit të konferencave të tilla është pak e ndryshme nga konferencat që organizohen zakonisht.

Konferenca e ESSE-s

Duke pasur parasysh përmasat e saj, ajo ndahet në disa rubrika të veçanta. Përveç sesioneve plenare, ka edhe sesione nënplenare. Paraqitjet e punimeve organizohen në formën e seminareve dhe tavolinave të rumbullakëta, të cilat organizohen sipas një teme specifike. E reja e këtij viti është organizimi i një sesioni për studentet e doktoraturës. Ata ftohen të marrin pjesë për të paraqitur punën e tyre, fokusin e studimit të tyre. Për më shumë informacion mbi këtë ngjarje,

konsultoni faqen zyrtare të konferencës në <http://www.esse2012.org/en/>.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve tuaja është **31 janar 2012**.



Anëtarësime të reja

ASSE e ka shtuar mjaft veprimtarinë e saj gjatë vitit 2011. Kjo kulmoi me botimin e numrit të parë të buletinit të shoqatës, *in esse: English Studies in Albania* dhe me organizimin e konferencës së parë të saj të titulluar në mënyrë simbolike “Only connect...” në datat 11-13 qershor në Vlorë ku morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës.

Po ashtu ASSE pati nderin të mirëpresë Ekzekutivin e ESSE-s: presidentin e saj, Prof. Fernando Galván, sekretaren, Dr Slávka Tomáščíková dhe drejtorin e thesarit, Dr Tim Caudery, të cilët zhvilluan mbledhjen e tyre të radhës një ditë para fillimit të punimeve të konferencës në Vlorë.

Po ashtu, këto aktivitete rriten ndjeshëm interesin e shumë pjesëmarrësve për tu bërë pjesë e saj. Me këtë rast dëshirojmë t’ju kujtojmë të gjithë të interesuarve se procedurat e anëtarësimit në ASSE përcaktohen në nenet 4 dhe 5 të statutit të shoqatës. Më poshtë do të gjeni këto nene.

Neni 4 – Anëtarësimi

ASSE është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimdhënës, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues, mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësimdhënës të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre

Anëtarë nderi: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

Neni 5 – Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikantit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësim e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përrjashtohen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.

Kuotacionet për vitin 2012

Janari është edhe muaji i derdhjes së kuotacioneve vjetore të anëtarësimit në ASSE. Me këtë rast, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata anëtarë që kanë qenë të përpiktë me këtë detyrim të përvitshëm dhe t'ju rikujtojmë se afati për detyrimin për vitin 2012 është fundi i janarit 2012. Procedurat do të bëhen të njohura shumë shpejt përmes një njoftimi elektronik. Për të gjithë anëtarët që nuk e zbatojnë këtë detyrim, bordi do të mblidhet për të diskutuar anëtarësimin e tyre.

Ju kujtojmë se shumica e kuotacionit nuk ka ndryshuar (35 euro) dhe se ky detyrim duhet përmbushur, jo vetëm, sepse tani që jemi pjesë e ESSE-s, një pjesë e kësaj shume shkon për kuotacionin për anëtarësim në ESSE, por edhe, sepse me kuotacionin ne nuk arrijmë dot të mbulojmë shpenzimet e aktiviteteve që kryejmë (buletini, mirëmbajtja e website-it etj). Shumë herë këto shpenzime kanë qenë kontribute personale.

Propozime për dy numrat e *in esse*

Për vitin 2012 shoqata parashikon botimin e dy numrave të radhës të buletinit *in esse*. Për këtë arsye, ftojme të gjithë anëtarët të na dërgojnë sugjerimet e tyre për thirrje të mundshme për këto dy numra. Idetë tuaja është mirë të zhvillohen në një paragraf shpjegues, në trajtën e një *call for papers* dhe të dërgohen me e-mail tek armelap@assenglish.org. Idetë e propozuara do të votohen pastaj nga të gjithë ne. Dy idetë më intriguese do të përbëjnë edhe titujt për dy numrat e 2012 të *in esse*.

Ftojme të gjithë anëtarët të jenë pjesë aktive e kësaj veprimtarie të shoqatës, me idetë dhe kontributet e tyre shkencore.

Afati për propozimet tuaja është 15 janar 2012.

Botimet e konferencës ‘Only connect ...’

Siç kemi bërë të ditur edhe në informime të mëparshme, të gjithë artikujt e mbledhur të paraqitur në konferencën e parë të shoqatës “Only Connect...” janë mbledhur në fund të shtatorit 2011 e më pas u janë dërguar bashkëpunëtorëve tanë për redaktime dhe sugjerime. Një pjesë e këtyre artikujve janë parë, të tjerat janë ende në proces shikimi.

Artikujt e përzgjedhur do të botohen në dy vëllimet e *in esse* për vitin 2011, duke i grupuar sipas specifikave studimore dhe tematike. Njëri vëllim do të përmbajë artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe tjetri nga fusha e letërsisë dhe e kulturës.

Ne besojmë se do të arrijmë të prodhojmë dy vëllime me kontribute interesante, të cilat do të nxisin dhe rrisin nivelin shkencor në fushën e studimeve në gjuhën angleze, por interesin e të gjithë atyre që lëvrojnë në këtë fushë për tu bërë pjesë e ASSE-s.

Propozime për konferencën e dytë të ASSE-s

Pas suksesit të arritur me konferencën e parë është koha miq që të fillojmë të mendojmë për konferencën e dytë. Kjo do të thotë, së pari, të mendojmë për një temë të mirë, e cila do të tërheqë jo vetëm sa më shumë pjesëmarrës, por, mbi të gjitha, sa më shumë punime të mira dhe së dyti, për vendin e organizimit të konferencës. Deri tani i kemi dy propozime, të cilat nuk mund t’i quajmë ende konkrete, por unë ju ftoj të gjithëve të mendojmë për këtë e ta diskutojmë së bashku me qëllim që ky aktivitet të jetë edhe më i suksesshëm.

Është e rëndësishme që thirrja për konferencën të hidhet brenda gjysmës së parë të vitit që vjen me qëllim që t’i lihet kohë e mjaftueshme organizimit të këtij aktiviteti.

